

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

S. G. nga ...”,

I përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat S. K. nga ...

Kundër;

V. J. M., me vendbanim në, R. Serbisë,

(Adresa për dërgimin e shkresave, Projekti, ”Ofrimi i ndihmës juridike dhe informatave të domosdoshme për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të personave të shpërngulur, refugjatëve dhe të kthyerve “,zyra Graqanicë, adresa: Kneza Lazara pa nr.,(Qendra tregtare, kati II.)

Palë përgjegjëse në ankesë/paraqitësi i kërkesës në AKP/

Duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/276/2019, të datës 13 Dhjetor 2019, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave, me numër KPA16075, (sipas kërkesës së palës kërkuese V. M.), në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 21 janar 2021, merr këtë;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga S. G., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/276/2019, të datës 13 dhjetor 2019, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP, me numër KPA16075.**

2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/276/2019, i datës 13 dhjetor 2019, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP, me numër KPA16075.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Me datë 18 shtator 2006, V. J. M.ć, (në tekstin e mëtejshëm: pala përgjegjëse në ankesë), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejshëm: AKP), në cilësinë e pronarit me 1/1, pjesë ideale, me të cilën kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri posedimin e ngastrës kadastrale me numër ..., me kulturë arë e klasës së katërt në sipërfaqe prej 0ha.20ar.40m2., e cila gjendet në vendin e quajtur, " ...", evidentuar në fletën poseduese nr. 116, Zona Kadastrale ..., Komuna
2. Në formularin e kërkesës pala përgjegjëse në ankesë thekson se, posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur me 24 mars 1999, si rezultat i rrethanave që ndërlidhen me konfliktin e armatosur të viteve 1998/99.
3. Në mbështetje të kërkesës në AKP ka dorëzuar dokumentet në vijim;
 - Kopjen e planit kadastral me numër ..., të dt. 27.11.2002, lëshuar në Enti Republikan për Gjeodezi i R Serbi, (shërbimi për kadastër të paluajtshërive Lipjan), sipas të cilit ngastra kadastrale nr. ..., në sip. prej 0.20.40ha., me kulturë arë e kl. katërt, në vendin e quajtur, " ...", Zona kad Komuna ..., sipas fletës poseduese me numër ..., evidentohet në emër të palës përgjegjëse në ankesë me 1/1/ pjesë ideale.
 - Kopjen e Letërnjoftimit në emër të tij, Reg. nr. ..., dhe nr. personal, ..., lëshua me datë 14.03.2000, nga MPB Beograd.
4. Me datë 21.11.2007, AKP bëri njoftimin e kërkesës duke vendosur tabelën informuese në pronën lëndore, e njëjta në kohën e kësaj vizite ishte gjendur të jetë tokë e pa punuar dhe e pa uzurpuar. Notifikimi dhe konfirmimi ishte bërë edhe për mes publikimit me datë 24.09.2010, për mes gazetës nr. 9, në Buletinin e zyrtar të UNHCR, në organet e tjera si K. Lipjan, kadastër, Gjykatë Komunale, mandej në UNHCR, Ombudsperson, KCA, DRC dhe zyrën e UNMIK në Graqanicë.

5. Kërkesa e palës përgjegjëse në ankesë pas njoftimit të pronës nuk ishte kontestuar nga askush në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditë, andaj nga AKP është trajtuar si jo e kontestuar.
6. Sipas raportit të verifikimit dhe raportit final të dt. 20.03.2008, ishte konfirmuar edhe *ex officio* se prona lëndore ngastra kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 0.20.40ha., sipas Certifikatës të drejtave pronësore nr. UL-..., e verifikuar me datë 20.03.2008, në departamentin e kadastrit në ..., evidentohet në emër të palës përgjegjëse në ankesë M. V. (J.), si pronarë ligjor me 1/1, pjesë ideale.
7. Me 23 shkurt 2011, me vendimin e vet KKPK/D/A/100/2011, Komisioni vendosi që paraqitësi i kërkesës KPA 16075,(pala përgjegjëse në ankesë), V. J. M., e ka dëshmuar se është pronar me 1/1, pjesës ideale, i pronës së kërkuar-ngastrës kad. nr. 29/1, në sipërfaqe prej 0he.20ar.40m2, dhe e ka të drejtën në posedimin e pronës së kërkuar.
8. Megjithatë me Rezolutën nr. KPCC/RES/46/2019, të datës 27 Shtator 2019, Komisioni për Kërkesa pronësore të Kosovës, vendimin e tij nr. KPCC/D/A/100/2011, të dt. 23 shkurt 2011, e kishte shfuqizuar, për shkak se kërkesa lidhur me pronën lëndore përkatësisht prona lëndore nuk ishte identifikuar dhe notifikuar ashtu si duhet.
9. Pas anulimit të vendimit të cekur si më lartë nga AKP, kërkesa e palës përgjegjëse në ankesë M. V. KPA16075 është ripërpunuar. Gjatë ri-notifikimit të bërë me datë 01.11.2019, në bazë të shënimeve të vjetra, prona lëndore- ngastra kad. ..., është gjetur se është e uzurpuar, e cila në bazë të hartave të reja kadastrale nuk ekzistonte në kadastër, pasi që e njëjta ishte bashkuar në ngastrat e reja ..., ...dhe Këto ngastra janë gjetur tokë e pa kultivuar të uzurpuara nga persona të pa njohur. Megjithatë në të dhënat kadastrale, prona lëndore ende është e regjistruar në emër të palës përgjegjëse si ngastër kadastrale me nr. ... Zyrtarët në kadastër Lipjan nuk kishin ofruar informata se si ishte bashkuar prona lëndore pasi nuk kishin të dhëna. Ata kishin deklaruar se të dhënat mund të gjenden vetëm në kadastrën e zhvendosur në Krushevac-Serbi.
10. Sekretaria e AKP-së me datë 04.10.2019, *ex officio*, në kadastër Lipjan kishte gjetur Certifikatën e të Drejtave Pronësore,(CDP) me nr., që tregon se ngastra e kërkuar 29/1, është e regjistruar në emër të palës kërkuese V. M. me 1/1, pjesë ideale.
11. Pala ankuese S. G. si palë përgjegjëse,(tutje PP1),me datë 11 nëntor 2019 ishte paraqitur në AKP dhe e kishte kontestuar kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë. Ai e kishte nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në procedurë si palë përgjegjëse. I Njëjti kishte

pohuar se në vitin 2016, e ka blerë ngastrën kadastrale nr. ... dhe ..., nga M. D.,(tutje pala e tretë). Gjatë komunikimit telefonik me sekretarin e AKP-së, ai kishte deklaruar se i ka blerë ngastrat e lartë cekura nga PP2 R. S., dhe për mes rrugësligjore për mes noterit i ka regjistruar në emër të tij. PP1 në mbështetje të pretendimeve të tij kishte paraqitur disa dokumente por ato nuk kishin të bënin me pronën lëndore ngastrën ., por ngastrën kadastrale nr. ...

12. B. C. po ashtu ishte paraqitur në AKP me datë 14 nëntor 2019, si anëtar i bashkësisë familjare të R. S. (tutje; ...), i cili po ashtu e kishte kontestuar kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë. I njëjti kishte deklaruar se në vitin 2016, ai e ka blerë ngastrën kadastrale nr. ..., e cila gjendet në Zonën Kadastrale ... ,Komuna ... , dhe ngastrën kadastrale nr. ..., nga M. D.,(pala e tretë). Në mbështetje të pretendimeve të tija ai kishte paraqitur disa dokumente të cilat nuk kishin të bënin me pronën lëndore por ngastrën kadastrale nr.... dhe 1917.
13. I kontaktuar nga sekretaria e AKP-së, PP1, gjatë bisedës telefonike ka deklaruar se e ka blerë pronën lëndore të kërkuar nga PP2 R. S., ngastrat kadastrale nr. . dhe ..., për mes rrugës ligjore-zyrës noteriale sipas kontratës i ka regjistruar në kadastër në emër të tij.
14. Anëtari i bashkësisë familjare i PP2 R. S., gjatë kontaktit me sekretarin e AKP-së, kishte deklaruar se PP2, është bashkëpronar i pronës sipas dokumenteve të paraqitura.
15. Megjithate pala përgjegjëse në ankesë gjatë bisedës me sekretarin e AKP-së kishte deklaruar se pronën e kërkuar nuk e ka shitur asnjëherë.
16. Me datë 13 dhejtor 2019, me vendimin nr. KKPK/D/A/276/2019, Komisioni vendosi që paraqitësi i kërkesës KPA 16075,(pala përgjegjëse në ankesë), V. J. M., e ka dëshmuar se është pronar me 1/1, pjesë ideale, i pronës së kërkuar-ngastrës kad. nr., në sipërfaqe prej 0he.20ar.40m2, dhe e ka të drejtën në posedimin e pronës së kërkuar, ndërsa palët përgjegjëse apo çdo person tjetër që gjendet në pronë duhet ta liroj të njëjtën në afatin e caktuar ose do të dëbohen nga prona. Në arsyetim të vendimit të përbashkët, në paragrafët 19-12, ipen arsyet për kërkesën lëndore ku ndër të tjera theksohet se; nga dëshmitë e ofruara nga pala kërkuese, Plani kadastral dhe në bazë Certifikatës të Drejtave pronësore e siguruar *ex officio* nga sekretaria e AKP-së me dt. 03 Tetor 2019, e paraqet paraqitësin e kërkesës si pronar i pronës së kërkuar. Palët përgjegjëse kanë pohuar se ata e kanë blerë ngastrën kadastrale nr. .. dhe 1917/7, por sidoqoftë dokumentet që ata i paraqesin në mbështetje të pretendimeve të tyre nuk kishin të bënin me pronën

lëndore ngastrën kadastrale nr.. Andaj bazuar në dëshmitë para tij e në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga palët përgjegjëse komisioni arrin në përfundim se kërkesa duhet të miratohet.

17. Me datë 26 shkurt 2020, Vendimi i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë V.M., i njëjti ankesë kundër tij nuk ka ushtruar.
18. Vendimi i njëjtë i KKPK-së, me datë 02 qershor 2020, i është dorëzuar PP1, S. G.. Ndërsa me datë 03 qershor PP2 B.C..
19. Kundër këtij Vendimi, me datë 26.06.2020, ankesë në Gjykatën Supreme ka ushtruar pala ankuese S. G. për mes të autorizuarit av. S. K..
20. Pala përgjegjëse në ankesë V. M. ka paraqitur përgjigje në ankesën e palës ankuese me datë 17 Gusht 2020, për mes projektit për ofrimin e ndihmës juridike personave të shpërngulur, të kthyer dhe refugjatëve me seli në Graçanicë .

Pretendimet e palës ankuese

21. Pala ankuese vendimin e KKPK-së, e atakon për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të miratohet si e bazuar ashtu që vendimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesa e palës përgjegjëse në ankesë të refuzohet si e pa bazuar. Në arsyetim të ankesës ndër të tjera thekson se; paraqitësi ka ofruar kopje të planit e cila është e viteve të 70-at, e cila nuk përputhet me gjendjen e tanishme në teren të ngastrave të cilat kanë pësuar ndryshime gjeodezike andaj ai figuron si pronar vetëm me karakter deklarativ, se ai (pala ankuese) është pronar ligjor i ngastrës kad. ..., dhe ..., të cilat ngastra nuk janë në fqinjësi të ngastrës së kërkuar të palës kërkuese dhe se këto fakte kanë mundur të vërtetohen në kadastrën në Lipjan, andaj është e habitshme që ai të detyrohet ta liroj pronën lëndore siç theksohet në pikën 11 të arsyetimit të vendimit të ankimuar etj.
22. Pala ankuese, ankesës i bashkëngjit;
 - Kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmëris të noterizuar me nr. LRP.nr.... ,për ngastrën kad.
 - Aktvendimin e Drejtorisë për gjeodezi dhe kadastër Komuna Lipjan për regjistrimin e pronës në regjistrin e paluajtshmërive ngastrës kad. ... në emër të palës ankuese.

- Certifikatën e të drejtave pronësore , nr. ..., për ngastrën kad. ..., në emër të tij.
(Vërejtje këto dëshmi nuk kanë të bëjnë me ngastrën kad. lëndore me nr.)

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë;

23. Pala përgjegjëse në ankesë, në përgjigjen e tij në ankesën e palës ankuese ndër të tjera thekson se; ngastra kad. ..., në kadastër sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore nr. P-..., të dt. 01.04.204, dhe 09.12.2019, është e regjistruar në emër të tij si pronarë ligjor, me 1/1, andaj me vendimin e Komisionit për Kërkesa Pronësore sipas kërkesës së tij KPA16075 i është kthyer pronësia dhe posedimi i saj, se pala ankuese ka paraqitur ankesë në këtë vendim por ankesa e tij ka të bëjë me ngastra tjera e jo me ngastrën lëndore dhe asnjëherë në procedurë nuk është vërtetuar se ngastra e tij është pjesë e ngastrave ... dhe ..., andaj propozon që ankesa e palës ankues të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa vendimi i AKP-së të vërtetohet.

Afatshmëria dhe lejueshmëria e ankesës,

24. Ankesa e ushtruar nga pala ankuese është e afatshme, është paraqitur brenda afatit ligjor. Sipas nenit 12.1, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e pa luajtshme private duke përfshirë pronën pronën bujqësore dhe ate komerciale, parashihet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë, nga njoftimi i palëve për vendimin.
25. Sa i përket pranueshmërisë së ankesës, sipas nenit 10.2, të Ligjit nr. 03/L-079 parashihet se çdo person tjetër për pos paraqitësit të kërkesë i cili aktualisht pretendon mbi pronën e kërkuar do të jetë palë në kërkesë dhe procedurë lidhur me ate kërkesë me kusht që personi i tillë të informoj AKP-në për synimet e tij ose të saj që të merr pjesë në procedurë, dhe sipas nenit 12.1 të njëjtit ligj brenda 30 dite të paraqes ankesë kundër vendimit të KKKP-së. Prandaj ankesa pranohet si e lejueshme sepse pala ankuese kishte marrë pjesë në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë duke e nënshkruar formularin e pjesëmarrjes në AKP me datë 08.11.2019.

Meritat e ankesës,

Arsyetimi ligjor;

26. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, pretendimeve të palës ankuese dhe palës përgjegjëse në përgjigjen në ankesën e palës ankuese, Gjykata Supreme gjen se, ankesa është e pabazuar, ndërsa vendimi i KKPK-së është i drejtë dhe ligjor. Gjykata nuk gjeti prova se Vendimi i ankimuar është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të fakteve lidhur me gjendjen faktike, dhe as me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale, ashtu si thekson pala ankuese në ankesë.
27. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999.
28. Pasi që paraqitësi i kërkesës(pala përgjegjëse në ankesë), e cek se data e humbjes së posedimit në pronën e kërkuar është 24 mars 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë, dhe me që i njëjti e ka dëshmuar të drejtën e tij pronësore, ndërsa nuk është dëshmuar se prona e kërkuar është shitur apo tjetërsuar në një mënyrë tjetër, nga këto fakte kërkesa e tij nga KKPK-ja, me të drejtë është vendosur në favor të tij.
29. Gjykata Supreme pajtohet me vendimin e KKPK-së, se pala ankuese, përderisa pretendon të drejtë ligjore ndaj pronës kontestuese, nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër valid në mbështetje të drejtës së tij, për ngastrën kadastrale nr. 29/1. Ai në AKP dhe tani në ankesë e pohon se e ka blerë ngastrën kadastrale nr. ..., dhe ngastrën kad Dokumentet e ofruara nga ai i referohen këtyre ngastrave e jo pronës së kërkuar lëndore.
30. Pala ankuese për veç se është deklaruar deklarativisht për mes parashtresave me shkrim në shkallën e parë, si edhe tani në ankesë ku thekson se, pala përgjegjëse në ankesë e ka paraqitur gjendjen kadastrale të viteve të 70-ta, e cila tani nuk përputhet me gjendjen e parcelave në teren të cilat kanë pësuar ndryshime, se ai nuk paraqet dëshmi se me cilën ngastër kufizohet prona e tij, se mbi çfarë baze kjo ngastër ..., është e regjistruar në emër të tij, apo e njëjta është shpronësuar në vitet 1959 dhe si rezultat është ndarë kjo ngastër

në ... dhe ... etj, ai nuk ofron asnjë dëshmi konkrete valide me vlerë juridike që do ti mbështesnin në mënyrë të argumentuar këto pretendime të tij.

31. Në anën tjetër sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore nr. P-..., të dt. 01.04.2014, dhe 09.12.2019, prona lëndore ngastra kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 0.20.40ha., në departamentin e kadastrit në Lipjan, evidentohet në emër të palës përgjegjëse në ankesë, M. V. (J.), si pronarë ligjor me 1/1,pjesë ideale. Ky dokument është verifikuar pozitivisht nga sekretaria e AKP-së në kadastër Lipjan.
32. Lidhur me pretendimet e tjra në ankesë, se komisioni nuk i ka vërtetuar faktet se ky është pronarë i ngastrës kad. nr. ... dhe ..., të cilat nuk janë as në fqinjësi me ngastrën e kërkuar lëndore, kolegji i vlerëson se nuk janë me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse në pikën 11 të vendimit të përbashkët të ankimuar është theksuar se, palët përgjegjëse janë pronarë të ngastrave nr. ... dhe ..., të cilat janë në emër të tyre, por sidoqoftë dokumentet që i kanë ofruar në mbështetje të mbrojtës së tyre, nuk kanë të bëjnë me pronën lëndore, ngastrën kad.nr.
33. Gjykata Supreme ve në pah po ashtu sipas bazës ligjore si në vijim: Neni 5.3 i Shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2006/50, mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale thekson se: *“Procedura para Komisionit bazohet në parashtrësat verbale dhe dokumentat , aty ku e kërkon interesi i drejtësisë, seanca verbale. Në kuptim të nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, për kërkesat vendoset mbi bazën e parashtrësave nga palët, përfshirë provat dokumentuese”*. Andaj Gjykata vlerëson se lënda aktuale në shqyrtim nuk ka nevojë për sqarime shtesë, prandaj nuk është e nevojshme të zbatohet neni 12.10 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, që të mbajë shqyrtim apo të administroj prova tjera shtesë.
34. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë andaj konfirmimi i vendimit të KKKP-së, nuk është sjellë në dyshim nga theksimet në ankesë, sepse nuk bazohen në asnjë provë të vlefshme juridike.
35. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 , Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore;

36. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm andaj nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

GSK-KPA-A-01/2020, me datë 21 janar 2021

Bashkp. Profesional
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani